

Marrëveshje e Mirëkuptimit

për bashkëpunim reciprok

ndërmjet:

KGJK- Këshilli Gjyqësor i Kosovës

QKRMT - Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës

Prishtinë, Prill 2015

I. PËRMBAJTJA DHE QËLLIMI I MARRËVESHJES

1. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje kanë për qëllim përkrahjen e proceseve për avancimin e sistemit të drejtësisë penale në Kosovë, me theks në përmirësimin e aplikimit të paraburgimit, promovimit të alternativave ndaj paraburgimit dhe nxitjes së aplikimit të dënimeve alternative në raport me dënimet me burgim.
2. Bashkëpunimi reciprok i palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje bëhet me qëllim të ngritjes së efikasitetit të sistemit penal gjyqësor të gjykatave në Kosovë përmes monitorimit kualitativ dhe profesional të procedurave dhe proceseve gjyqësore dhe raportimit mbi indikacionet dhe gjetjet kryesore.
3. Përmes procesit të monitorimit dhe publikimit të raporteve të monitorimit të sistemit të gjyqësisë, synohet të arrihet ngritja e efikasitetit të aplikimit të paraburgimit dhe promovimi i aplikimit më të shpeshtë të alternativave ndaj paraburgimit duke promovuar modele dhe standarde më të avancuara në funksion të një sistemi human në drejtësinë penale.

II. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET


1. Bashkëpunimi i palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje do të bazohet në respektimin e plotë të standardeve më të larta profesionale dhe kodit të etikës.
2. KGJK do të mundësojë për të gjithë monitoruesit e akredituar të QKRMT:
 - a. qasje të plotë në lëndët e palëve në gjykatë;
 - b. qasje të plotë në raportet e punës së gjykatave dhe
 - c. qasje të plotë në raportet e punës së KGJK-së.
3. Qasja e plotë e monitoruesve të QKRMT është e lejuar në të gjitha gjykatat e të gjitha niveleve në Kosovë.
4. QKRMT do të respektojë parimin e konfidencialitetit, pavarësinë e procesit gjyqësor si dhe parimin e qasjes profesionale ligjore dhe analitike gjatë procesit të monitorimit.
5. Publikimet dhe raportet të cilat dalin si produkt i këtij monitorimi do të reflektojnë në tërësi parimet e konfidencialitetit, pavarësisë së procesit gjyqësor si dhe qasjen profesionale dhe analitike.

6. Me nënshkrim të kësaj Marrëveshje Mirëkuptimi, palët nënshkruese obligohen për të realizuar në tërësi të gjitha obligimet dhe detyrat e përmendura në këtë memorandum.
7. Palët nënshkruese pajtohen që ky Memorandum i Mirëkuptimit të ketë afat deri me 31.04.2017 me mundësi vazhdimi, nëse palët për këtë pajtohen paraprakisht.
8. Palët nënshkruese pajtohen që kjo Marrëveshje Mirëkuptimi mund të anulohet nga cilado palë nënshkruese e me njoftim paraprak me shkrim në afat jo më shkurtër se 60 ditë për palën tjetër.

III.

1. Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi është hartuar në 4 (katër) kopje identike, nga dy për secilën palë nënshkruese.
2. Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.


për KGJK:


Enver Peci, Kryesues i KGJK

Prishtinë, më 20.04.2015

Nënshkruar:

për QKRMT:


Feride Rushiti, Drejtoreshë

